



Prioritetet e Këshillave Lokal

Projekti: “Qytetari aktive dhe komuna përgjegjëse në Kosovë”

Organizata joqeveritare Syri i Vizionit nga Peja, në kuadër të projektit “Qytetari aktive dhe komuna përgjegjëse në Kosovë” ka mbajtur takime me kryetarët e këshillave lokal në gjashtë (6) komuna ku ky projekt shtrihet: Rahovec, Gjakovë, Deçan, Klinë, Istog dhe Pejë.

Qëllimi i këtyre takimeve me kryetarët e këshillave lokal ishte radhitja e prioriteteve, tri (3) deri në pesë (5) me të rëndësishmeve për lokalitetin e tyre, në mënyrë që komunat në investimet e tyre kapitale dhe planifikimet buxhetore për vitin 2023 t’i përfshijnë këto prioritete duke ndikuar në përmirësimin e drejtpërdrejtë të kushteve të jetesës dhe mirëqenien e banorëve dhe rritur transparencën e investimet me përfshirjen e drejtpërdrejtë të qytetarëve.

Duhet theksuar se në takimin me kryetarët e këshillave lokal nuk kanë marrë pjesë të gjithë kryetarët, pavarësisht ftesave të dërguara me kohë dhe mundësisë së ofruar që prioritetet e tyre t’i adresojnë tek ne edhe me shkrim.

Prioritetet e dala nga takimi me kryetarët e këshillave lokal në komunën e Gjakovës janë si më poshtë:

Prioritet e këshillave lokal të dala nga pjesëmarrësit në takim

Bashkësia VIII Blloku i ri

1. Rregullimi i shtratit të Lumit Krena nga Ura e Taliqit deri të ish-kazerma te spitali
2. Ndërtimi i një ure e cila lidhë Mahallen e Mullaisufit me Lagjen Gecë më një gjatësi prej 28 gjerësi dhe gjatësi prej 8 metrash
3. Rregullimi parkut të Gecës apo në Mahallen e Gecës
4. Rregullimi i qendrës universitare të ish-kazerma (kampus).

Rogovë

1. Rregullimi apo ndërtimi i urës së re “Ura e Rogovës” mbi lumin Drini i Bardhë
2. Përfundimi i shtëpisë së kulturës e cila ka filluar nga MKRS-ja, por ka mbetur si objekt me punime të papërfunduara
3. Ndërtimi i kanalit për ujërat atmosferike prej Rrugës së Muhadrit deri tek Përroi i Cilit
4. Asfaltimi i rrugicave të fshatit dhe lidhja me rrugën kryesore si dhe riparimi i gropave përgjatë rrugës kryesore apo në rrugën kryesore
5. Ndërtimi i pikave për grumbullimin e produkteve bujqësore.

Skivjan

1. Kanalizimi i ujërave të zeza në Osek e Skivjan dhe lidhja e këtyre dy fshatrave me rrjetin apo gypin kryesore të ujërave të zeza
2. Mungesa me furnizim me ujë të pijes
3. Sigurimi i një lokacioni për mbeturinat inerte. Nuk ka deponi te caktuar për këto mbeturina dhe ato të ngurta
4. Ndërtimi i zhveshtoreve në fushat sportive në fshatrat Skivjan, Dukagjin të Novosellës dhe Pashtrik të Rogovës
5. Ndërtimi i kanalit të ujitjes.

Dublibare

1. Asfaltimi i rrugës nga Dublibare në Vraniq diku 6 kilometra, pasi që është dëmtuar nga kamionët të cilët qarkullojnë vazhdimisht në atë rrugë
2. Përkthimi i pronave të Komostacionit - pronat e Dublibares dhe Dobrisanës
3. Pastrimi i përroit Vraniq- Dulibare. Të bëhet se paku 5 deri 6 herë në vit
4. Ndërtimi i sistemit të ujitjes për toka bujqësore.

Bec

1. Asfaltimi i dy rrugicave në fshat - diku 600 metra
2. Kubëzimi i tri rrugicave në Lagjen Hajdari dhe atë Ali Hasani
3. Asfaltimi i dy rrugicave në fshatin Drell në Lagjen Prenka - diku 400 metra
4. Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat e zeza në lagjën Hajdari, Ndoja, Lulashi dhe Coli

5. Zhdrellë - ndërtimi i kanalizimit në Lagjen Prenka dhe atë Bibaj - diku 400 metra
6. Ndërtimi i kanalit të ujitjes Bec-Zhdrellë - diku 1300 metra
7. Asfaltimi i dy rrugicave në “Lagjja e Minoriteteve” në Bec dhe kanalizimi për ujërat e zeza diku 200 metra.

Ponoshec

1. Ndërtimi i Sheshit të Dëshmorëve të vitit 1913. Projekti është hartuar tri vite me parë me një kosto afër 18000 euro
2. Ndërtimi i katit të dytë të ambulancës për të ofruar shërbimin e dhënies së infuzionit
3. Fillimi i ndërtimit të nënstacionit të zjarrfikësve pasi që kjo zonë është e mbjellë me pisha dhe rrezikohet nga zjarrëvëniet e qëllimshme apo nga zjarri gjatë sezonit të verës
4. Ndërtimi i shtëpisë së kulturës dhe qendrës rinore.

Brekoc

1. Ndërtimi i trotuarit për këmbësorë nga Ura e Tabakëve deri në Zhub, e cila ka një gjatësi prej 3.6 kilometrash.

Bashkësi VII Qytet

1. Krijimi i hapësire parkimi në komplet Bllokun e Ri
2. Funkcionalizimi i tregut të gjelbër
3. Ndërtimi i terrenit sportiv në hapësirat e shkollës “Yll Morina”
4. Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave dhe ndryshimi i vendeve për kontejnerë
5. Shtimi dhe mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese.

Novosellë e Ulët

1. Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat e zeza
2. Asfaltimi i disa rrugicave në fshatrat Novosellë, Trakaniq, Palabardh dhe Bitesh
3. Riparimi i sistemit të ujitjes së tokave nga kanali për furnizim deri në fshatra
4. Ndërtimi i fushave sportive, rrethojës, vendosja e bankinave për fushën e klubit të futbollit Dukagjini si dhe ndërtimi i zhveshtores
5. Caktimi i një lokacioni për mbeturina inerte/të ngurta.

Babaj i Bokës

1. Asfaltimi i rrugës Devë, Guskë, Babaj i Bokës dhe Korenicë - diku 7000 metra
2. Ndërtimi i një impianti për derdhjen e ujërave të zeza
3. Hapja dhe asfaltimi i rrugës në Lagjen Korenicë (që kanë të vrarë) pasi që nuk kanë rrugë.
4. Asfaltimi i rrugicave të fshatit

5. Eliminimi i deponisë ilegale e cila ndodhet te Ura e Erenikut, te Duzhnja
6. Ndërtimi i digës ku ka ekzistuar e vjetra si dhe kanalet e ujitjes.

Bashkësia numër IX-të Qytet

1. Të bëhen inspektime nga Inspektorati i Ambientit në Lumin Vogovoca dhe Miniera e Kormit

Dol

1. Shkolla e vjetër të shndërrohet në qendër rinore ose shtëpi të fshatit
2. Hapësirë në varrezat e fshatit Dol dhe Moglic
3. Renovimi i urës Dolicë apo ndërtimi i një ure të re.

Koment i përgjithshëm: Në qarkoren buxhetore për investime kapitale ku janë vendosur investimet nëpër rrugica lagje e fshatra të bëhet specifikimi i tyre me emër!

Ky dokument është hartuar në kuadër të programit “Qytetari aktive dhe komuna përgjegjëse në Kosovë” i cili zbatohet nga Syri i Vizionit, Communication For Social Development, EC Ma Ndryshe dhe Democracy Plus që kanë lidhur aleancë për zbatim të këtij programi i cili mbështetet financiarisht nga Olof Palme International Center.

Komuna: Gjakovë, shtator 2022